



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 67, 68 dhe 69 paragrafi 2 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrat e Publikë, nenin 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjakovës numër 01-110/04-29365, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Emri i grupit:	Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetit/Mjekësisë
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Njësia:	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Lloji i pozitave:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Data e njoftimit:	03.04.2023
Afati për aplikim:	03.05.2023 – 17.05.2023
Numri i referencës:	01-111/01-6980
Kohëzgjatja e emërimit:	E pacaktuar

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

Detyrat e punës do të kryhen në bazë të përshkrimit të detyrave të punës të **Teknikut të Farmacisë, Infermierit dhe Teknikut Laborant** të parapara sipas Rregullores mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të QKMF-së dhe në dispozita tjera ligjore në fuqi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

Arsimimi i kërkuar:

- Teknik i Farmacisë: Diplomë e shkollës së mesme, drejtimi Farmaci (të jetë i licencuar).
- Infermier i Përgjithshëm: Diplomë e shkollës së mesme, drejtimi Infermier i Përgjithshëm (të jetë i licencuar).
- Teknik Laborant: Diplomë e shkollës së mesme, drejtimi Laborant (të jetë i licencuar).

Përvoja e punës e kërkuar: Minimumi të ketë të mbaruar stazhin e obliguar profesional.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme:

- Të jetë i regjistruar dhe licencuar në MSH;
- Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të ketë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip si dhe shkathtësi të mira komunikimi;

- c. Shkathhtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);
- d. Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race.

5. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Vendi i punës
1.	Teknik i Farmacisë	5.1	QKMF
2.	Infermier i Përgjithshëm	5.1	AMF në Bishtazhin (QMF në Rogovë)
3.	Teknik Laborant	5.1	QMF në Skivjan

6. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimi* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- b. Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- c. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- d. Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- e. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- f. Kopjen e licencës;
- g. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj*);
- h. Certifikata e Mjekut pas përzgjedhjes nga komisioni.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Testimi me shkrim
- b. Intervistë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

10. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- c. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë.
- d. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.